



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. ....61..... Prot  
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 25/ 02 / 2023

**VENDIM**

Nr.11, date 25 /04/2023

**PËR**

**RAPORTIN VJETOR PER VITIN 2022 TE SHFRYTEZIMIT, OPERIMIT, MIREMBAJTJES,  
MONITORIMIT DHE SIGURISE SE DIGES URA E FANIT E HEC FANGUT**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndertimin, Shfrytëzimin dhe Mirembajtjen e Digave dhe Dambave" dhe VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave", Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 25.04.2023 mori në shqyrtim Raportin vjetor për vitin 2022 në lidhje me shfrytëzimin, operimin, monitorimin dhe sigurinë e digës së Urës së Fanit të HEC Fangut të paraqitur nga Shoqëria AYEN AS ENERGJI SHA.

Në raportin vjetor është dhënë një informacion i detajuar në lidhje me gjëndjen e digës, të dhënat e monitorimit të saj, investimet e kryera gjatë vitit 2022, planet e gadishmërisë dhe ekipin e sigurisë së digës, problematikat kryesore gjatë vitit 2022 si dhe konkluzionet e shfrytëzuesit të digës në lidhje me gjëndjen e digës dhe sigurinë e saj.

Në Raport **nuk është dhënë informacion në lidhje me skemat e sistemeve të monitorimit të instaluar në digë** (skema e vendosjes së instrumentave të këtyre sistemeve) si dhe **vlerësimi i aseteve të digës** dhe të elementeve kryesore të saj (Diga, Shkarkuesit fundor dhe siperfaqësor, Vepra e marrjes, sistemet e monitorimit, rezervuari, etj)

Gjithashtu, sipas Raportit dhe rezultateve të dhëna rezultojnë se filtrimet në pjesën e poshtme të digës për 4 matjet e kryera gjatë vitit 2022 janë në sasinë prej 92 deri 94 l/sek. Kjo shifër rezultojnë të jetë shumë më e lartë se sasia e filtrimeve maksimale të dhëna në projektin e miratuar të kësaj dige megjithëse në gjykimin e shfrytëzuesit vlera e dhënë është e pandryshueshme. Duke qenë se nuk janë dhënë vlerat e sasisë së filtrimeve ndër vite që nga fillimi i shfrytëzimit të digës si dhe duke patur parasysh faktin e një sasive më të madhe se sasia e përcaktuar në projekt antarët e KTPD dhe KKDM kërkuar të jepet me shumë informacion në lidhje me këtë problematikë si dhe të bëhet një analizë e thelluar në lidhje me sasinë e filtrimeve, rrugët e këtyre filtrimeve si dhe të cilësisë së ujit që del nga këto filtrime. Pas diskutimeve të të gjithë antarëve të pranishëm, KKDM

**VENDOSI:**

1- Ti kërkohet shoqërisë AYEN AS ENERGJI si shfrytëzuese e digës së Urës së Fanit:

- Dërgimin e të dhënave të monitorimit të sasisë dhe cilësisë së filtrimeve të konstatuara në pjesën e poshtme të digës për 5 vitet e fundit brenda muajit Korrik 2023
- Kryerjen e një analize dhe studimi të thelluar nga eksperte me eksperience dhe të kualifikuar në lidhje me sasinë dhe cilësinë e filtrimeve të konstatuara, rrugët e mundshme të kalimit të ujrave nëntokesore të këtyre filtrimeve,
- Kryerjen e monitorimit të sasisë dhe cilësisë së ujrave të këtyre filtrimeve në kohe reale online me anë të instrumentave me një frekuencë të paktën një herë në javë gjatë të gjithë vitit 2023.
- Dërgimin e të dhënave për sasinë e ujit të shkarkuar dhe ditët e shkarkimit të ujit të tepërt nga shkarkuesit sipërfaqësor për periudhën e 5 viteve të fundit.

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të Mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për ndjekjen dhe zbatimin e masave të kerkuara në këtë Vendim sipas legjislacionin në fuqi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë

**KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA**

**KRYETARI**  
Arjan JOVANI

